



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:238403  
Datë: 23.10.2024  
Numri i dokumentit: 06336322

**C-IV-14-3095**

*Ankuesi*

**I G** fshati G, Klinë.

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 17 tetor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PEJ068-0159 datë 26 dhjetor 2013.
- OBLIGOHET** e paditura AKP që ankuesit **I G** në emër të kompensimit për paga të papaguara nga NSH “Mirusha” për periudhën 1 nëntor 2001 – 30 prill 2002, t’i paguaj **shumën prej 2,070.00 €** si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 207.00 €**.
- Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës **në shumë prej 20.00 €**.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 10 shkurt 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ068-0159, të datës 26 dhjetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës në shumë prej 2,070.00 € nga NSH “Mirusha” (në likuidim) Klinë. Ankuesi pohoi se i drejtohet DHPGJS-së si autoritet respektabil që pas shqyrtimit të fakteve vendimtare nga kjo ankesë si dhe rishikimit të vendimit të AL, duke pasur parasysh edhe provat tjera lëndore të miratoj kërkesën e tij si të

bazuar duke anuluar vendimin lëndor dhe duke i njohur të drejtën e tij ligjore në kompensimin e 6 pagave mujore përkatëse të papaguara dhe atë nga data e pagesës së të ardhurave personale nga 01 nëntor 2001 – 30 prill 2002, krejt kjo sipas regjistrimit mbi llogaritjen e të ardhurave personale i cili iu kishte bashkangjitur padisë së rregullt ligjore të evidentuar në ish Gjykatën Komunale në Klinë të datës 15 tetor 2002, numër C.nr. 262/02. Po ashtu ankuesi kishte njoftuar ish AKM-në për mos pagesën e 6 pagave të papaguara për periudhën e lartcekur në afatin ligjor dhe ishte deponuar me kohë edhe tek organet kompetente të ish AKM-së si dhe pranë gjykatës kompetente në Klinë. Andaj pretendimet e AL se kinse pala nuk ka paraqitur kërkesë të afatshme për kompensim të pagave të papaguara për periudhën e lartcekur për çështjen lëndore nuk qëndrojnë. Pas krejt këtij procesi të rregullt dhe të afatshëm ligjor, i bërë nga gjithë në emër të punëtorëve dhe provave të tilla, nuk mund të konstatohet parashkrimi i çështjes siç ka vepruar Këshilli i Likuidimit duke u thirrur në nenin 608 të LPB dhe duke refuzuar pa të drejtë kërkesën e palës mbi atë bazë. Në fakt te Këshilli i Likuidimit nuk ishin paraqitur të gjitha provat e tilla që e argumentojnë kërkesën tonë edhe pse Zyra Regjionale e AKP-së në Pejë ishte në dijeni, por që tani këto prova i paraqitën DHPGJS për të demantuar çështjen e parashkrimit. Formulari i Këshillit të Likuidimit nuk kishte hapësirë të mjaftueshme për paraqitje të të gjitha provave dhe fakteve dhe sqarimit meritor të tyre (ndoshta ai format ishte bërë me qëllim asisoj – vërejtja e ankuesit) si do që të jetë tani gjykata si organ gjyqësor respektabil ka në dispozicion të gjitha provat dhe faktet vendimtare për vendosje meritorë, të cilat prova paraqesin kontinuitetin e afatshmërisë së kërkimit të mbrojtjes së çështjes lëndore nga punëtorët – pala. Mbi këto fakte notore që tani mund të konfirmohen edhe nga ana e vet punëtorëve normalisht ata e kishin kërkuar të drejtën e tyre me kohë dhe në afat ligjor pranë Gjykatës Komunale në Klinë si dhe pranë autoriteteve të organeve të ish AKM-së. Sipas tërë kësaj gjendje faktike dhe juridike konfirmohet qartë se punëtorët e NSH-së kishin kërkuar në afatin ligjor mbrojtjen e çështjes lëndore, prandaj vendimi i Këshillit të Likuidimit për refuzimin e kërkesave të punëtorëve – palës, kinse mbi bazë të parashkrimit sa është absolutisht i pa bazuar po aq është i pa drejtë, i pa pranueshëm dhe diskriminues prandaj përmes kësaj ankese lëndore kërkojmë zbardhjen dhe vendosjen meritorë të çështjes, ngase fare nuk mund të vie në shprehje parashkrimi i kërkesës së palës karshi apelimeve të rregullta dhe të afatshme që ishin bërë dhe që u sqaruan më lartë. Ankuesi më tej thekson se ekziston shkelja qenësore e dispozitave procedurale që i referohen procedimit të AL, duke konsideruar se AL me rastin e vendosjes lëndore është dashur që ta ftoj dhe të dëgjoj në procedim të rregullt për faktin se rrethanat e rastit është dashur të shqyrtohen dhe të sigurohet edhe deklarata e tij gojore në atë mënyrë që të më jepet mundësia e deklarimit dhe sqarimit të fakteve vendimtare dhe provave mbështetëse të kërkesës. Më tej theksoi se ekziston vërtetimi jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike, duke konsideruar se krejt kjo konsiston në atë se vet mos dëgjimi i paraqitësit të kërkesës dhe mos marrja e deklaratës së tij dhe sqarimit të tij, po edhe mos shqyrtimi i provave të bashkangjitura kësaj kërkesë, e ka qar AL në vendosje të gabuar dhe jo të plotë dhe jo meritorë. Ankuesi më tej theksoi se ekziston aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, që në rastin konkret shihet në atë se Autoriteti i Likuidimit vendimin kontestues e ka mbështetur ekskluzivisht në Ligjin e Punës së Bashkuar si ligj për të cilin mendojmë se është shfuqizuar dhe i ka kaluar koha në raport me të gjitha dispozitat tjera të akteve ndërkombëtare dhe vendore pozitive të veçanta që i referohen të drejtës së garantuar të pagës së punëtorëve, pra edhe të vet Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034, nenit 40. Kategoria e pagave pra është e drejtë e garantuar me akte ndërkombëtare po edhe e drejtë e garantuar kushtetuese,

për punëtorët si në çdo vend të botës edhe në shtetin e Kosovës. Ankuesi më tej shton se normalisht nëse paraqitet nevoja e mëtejme këtë çështje do të kërkojmë të sqarohet edhe në të gjitha organet tjera më të larta të gjyqësisë në Kosovë po edhe deri në Gjykatën e Strasburgut. Në anën tjetër po përsërisim se është më shumë rëndësi se Konventat Ndërkombëtare, sipas Kushtetutës së Kosovës kanë zbatim prioritar dhe të drejtpërdrejtë në Shtetin e Kosovës prandaj organi i vendosjes është dashur *apriori* të merr parasysh konventat përkatëse që rregullojnë dhe garantojnë të drejtën e pagës si:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, shpallur me Rezolutën e KB-ra 271 A me datë 10 dhjetor 1948,
2. Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës – ONP nr.131 për caktimin e nivelit të pagave, e miratuar në vitin 1972,
3. Konventa e ONP-së nr.95 për Mbrojtjen e Pagave dhe
4. Konventa e ONP-së nr.111 kundër Diskriminimit në Punë, datë 25 qershor 1958.

Anashkalimi i këtyre akteve ndërkombëtare ligjore vendimin kontestues të AL e bënë të pa pranueshëm dhe AB Initio – të refuzueshëm nga fillimi. Në tjetrën anë AL si organ i vendosjes detyrimisht ka qenë dashur në përparësi të zbatoj të drejtën e veçantë materiale që i referohet AKP-së, pikërisht Ligjin nr. 04/L-034 për AKP, prandaj dispozita kogente e nenit 40.1.1.6.1 ka qenë dashur të respektohet dhe zbatohet, e jo të i jepet përparësi zbatimit të një ligji siç është Ligji për Punën e Bashkuar (LPB). Ankuesi i propozoi gjykatës që të miratohet në tërësi si e bazuar ankesa dhe kërkesa për rishikimin e vendimit të AL, ashtu që lejohet rishikimi i vendimit të lartcekur dhe vendimi i rishikuar ndryshohet në kuptimin e njohjes të së drejtës së punëtorit në kompensimin e 6 pagave mujore të papaguara në lartësi prej gjithsejtë 2,070.00 € me kamatë ligjore nga data e parashtrimit të padisë C.nr.262/02 e datës 15 tetor 2002 e deri në pagesën definitive, krejt këtë në afatin paritiv 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nga ana e AKP-së, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësinë sipas vendimit të gjykatës apo përfundimisht ankuesit ti pranohen 3 paga të garantuara ligjore, të cilat do ti caktoj gjykata sipas nenit 40 par. 1 pika 1.6.1 të Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në. Në mbështetje ankesës së tij ankuesi ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar dhe dëshmitë në kopje si: Padinë për kompensimin e të ardhurave personale dhe pagesën e kontributeve drejtuar Gjykatës Komunale në Klinë C.nr. 262/02 datë 15 tetor 2002, Listën e pagave të punëtorëve të NSH-së për muajt nëntor 2001 – prill 2002 dhe Kërkesën e NSH-së drejtuar AKM-së për kompensimin e të ardhurave personale me nr. protokolli 73 datë 27 dhjetor 2002.

Me 29 shtator 2022, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin me të cilin ndër të tjera kërkoi nga i njëjti që të dorëzonte prova shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. Urdhri u pranua nga ankuesi dhe i njëjti me 19 tetor 2022 dorëzoi në gjykatë një parashtrësë – plotësim ankese me propozim për miratim të ankesës dhe plotësimit të saj ashtu që pas rishikimit të vendimit të kundërshtuar i njëjti të ndryshohet në kuptim të njohjes së të drejtës së punëtorit në kompensimin e pagave të papaguara dhe të obligohet e paditura NSH “Mirusha” e përfaqësuar nga AKP, që ankuesit t’ia paguaj pagat e mbetura borxh në lartësi prej 2,070.00 € të gjitha këto me kamatë ligjore. Në mbështetje të saj ka dorëzuar / ri-dorëzuar dëshmitë në kopje si: Ekstrakt nga Aktvendimi nr. AC-I-14-0323 datë 04 mars 2015 lëshuar nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Lista e punëtorëve të NSH-së – Përlllogaritja e 20 % datë 27 mars

2006, Rekapitulacioni i pagave të punëtorëve për muajin korrik 2003, Listë pagesa e pagave për muajin korrik 2003 dhe Njoftimi për Përfundimin e Punësimit datë 07 shkurt 2006 lëshuar nga AKM.

Me 25 janar 2023, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedurë gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. E paditura thekson se pretendimet e parashtruesit janë të parashkruara pasi se nuk ka asnjë provë përpara AL që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent. (Afati 3 vjeçar i parashkrimit). Pra, kërkesa e parashtruesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së ligjit 04/L-034 dhe Nenin 608 të LPB. Qëndrimi i të paditurës është se afati i parashkrimit nuk lejon që AL dhe DHPGJS të analizojnë dhe shqyrtojnë themelin e rastit. AL dhe DHPGJS nuk mund të nxjerrin një vendim që NSH i ka mbetur borxh për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës. Vet kuptimi i parashkrimit është vjetërsimi i një të drejte të pretenduar për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara me ligj, që vështirësojnë vërtetimin e rrethanave të çështjes pikërisht për shkak të kohës që ka kaluar. AKP më tej thekson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se: *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ...kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Prandaj, ky AL refuzon këtë kërkesë si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. Në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar dhe Vendimin për përbërjen / emërimin e anëtarëve të AL datë 1 nëntor 2022.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*” .

Ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PEJ068-0159, datë 26 dhjetor 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme / parashkruar kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara, në shumë prej 2,070.00 € për periudhën kohore 1 nëntor 2001 – 30 prill 2002 nga NSH ”Mirusha” (*në likuidim*).

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Mirusha”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur NSH borxh pagat për periudhën 1 nëntor 2001 – 30 prill 2002. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se kërkesa e ankuesit për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa ankuesi pretendon se ka qenë në listën e pagave për periudhën e lartcekur në NSH. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij kryesisht e mbështet në: Padinë për kompensimin e të ardhurave personale dhe pagesën e kontributeve drejtuar Gjykatës Komunale në Klinë C.nr. 262/02 datë 15 tetor 2002, Listën e pagave të punëtorëve të NSH-së për muajt nëntor 2001 – prill 2002, Kërkesën e NSH-së drejtuar AKM-së për kompensimin e të ardhurave personale me nr. protokolli 73 datë 27 dhjetor 2002, Ekstraktin nga Aktvendimi nr. AC-I-14-0323 datë 04 mars 2015 lëshuar nga Kolegji i Apelit të Dhomës së

Posaçme të Gjykatës Supreme, Listën e punëtorëve të NSH-së – Përlllogaritjen e 20 % datë 27 mars 2006, Rekapitulacionin e pagave të punëtorëve për muajin korrik 2003, Listë pagesën e pagave për muajin korrik 2003 dhe Njoftimin për Përfundimin e Punësimit datë 07 shkurt 2006 lëshuar nga AKM si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga Lista e pagave të punëtorëve të NSH-së për muajt nëntor 2001 – prill 2002, Kërkesa e NSH-së drejtuar AKM-së për kompensimin e të ardhurave personale me nr. protokoli 73 datë 27 dhjetor 2002 dhe Lista e punëtorëve të NSH-së – Përlllogaritjen e 20 % datë 27 mars 2006, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “Mirusha” për periudhën kohore objekt kontesti dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat e papaguara në shumën e kërkuar nga ankuesi. Pra nga dëshmitë në fjalë e veçanërisht lista e pagave të punëtorëve të NSH-së për muajt nëntor 2001 – prill 2002, konstatohet se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit shumën prej 2,070.00 € në emër të pagave të papaguara për periudhën kohore 1 nëntor 2001 – 30 prill 2002, shumë kjo e kërkuar nga ankuesi në procedurën e likuidimit dhe objekt shqyrtimi në këtë procedurë. E paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës së kërkuar nga ankuesi në emër të pagave të papaguara për periudhën objekt kontesti.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, Listën e pagave të punëtorëve të NSH-së për muajt nëntor 2001 – prill 2002, Kërkesën e NSH-së drejtuar AKM-së për kompensimin e të ardhurave personale me nr. protokoli 73 datë 27 dhjetor 2002 dhe Listën e punëtorëve të NSH-së – Përlllogaritjen e 20 % datë 27 mars 2006, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palëve dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve në AL me 31 tetor 2013. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me rastin e dorëzimit të padisë për kompensimin e të ardhurave personale dhe pagesën e kontributeve drejtuar Gjykatës Komunale në Klinë C.nr. 262/02 datë 15 tetor 2002. Andaj, gjykata gjen se kërkesa e ankuesit nuk është e parashkruar pasi padia në fjalë ishte dorëzuar në gjykatë brenda afatit 3 vjeçar nga momenti i mos pagesës së pagës së parë të papaguar (nëntor 2001), prandaj vendimi i kundërshtuar i AL ndryshohet dhe aprovohet në tërësi kërkesa e ankuesit për kompensimin e pagave të papaguara në shumën e kërkuar, bazuar në arsyet e lartcekura.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 207.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalohet 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 €.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar